

# BULETINI MUJOR



SHKURT 2024

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



## QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT ME PAJISJE TË TEKNOLOGJISË SË LARTË

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKGJ), është transformuar rrënjosht pas rikonstrukzionit tërësor, duke e shndërruar në një qendër dinjitoze dhe bashkëkohore të cilësisë së lartë, me mëdise të një standari bashkëkohor në dhurim, testim, përpunim ruajtje dhe shpërndarje. E pajisur me teknologjinë më të lartë, mundësohet digitalizimi i plotë dhurues-pacient, sigurim i cilësisë maksimale të gjakut dhe garantimin e aksesit të barabartë ndaj gjakut të mjaftueshëm e cilësor në çdo skaj të vendit.



## INVESTIMI NË SPITALIN E MIRDITËS, KUSHTE DINJITOZE DHE CILËSI SHËRBIMI

Punimet në kantierin e Spitalit Bashkiak të Mirditës po vijojnë me intensitet për t'u përmbyllur brenda afateve të parashikuara. Investimi për transformimin e ambienteve të këtij spitali, i dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019, u mundësua në kuadër të Programit të Rindërtimit ku do të sjellë kushte dinjitoze dhe do të përmirësojë punën akoma më shumë, duke e ngritur në një nivel më të lartë. Shërbimet shëndetësore për qytetarët nuk janë ndalur në asnjë moment gjatë kësaj periudhe rikonstrukzioni.



## QENDRAT SHËNDETËSORE, SHËRBIM EDHE NË BANESË

Qendra Shëndetësore Fushë Arrëz ofron shërbim 24/7 për mbi 3 mijë banorë të zonës me kushte bashkëkohore dhe që ofron shërbim në banesë për 13 pacientë, të cilët e kanë të pamundur lëvizjen nga banesa e tyre.

Ndërkohë, në Fushë Arrëz, Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë ka marrë statusin e "Ndërmarrjes Sociale" për të fuqizuar ekonomikisht gratë dhe vajzat nëpërmjet formimit profesional dhe më shumë mundësi punësimi për të rinjtë e kësaj zone.

## RIKONSTRUKTOHET URGJENCA E SPITALIT TË KUÇOVËS

Shërbimi i urgjencës në Spitali Bashkiak të Kuçovës do të ofrojë kushte më të mira me infrastrukturë të re për një shërbim më të mirë për patientët. Punimet për rehabilitimin e urgjencës kanë nisur me fondet e spitalit dhe pritet të përfundojnë në muajin mars, ndërkohë që shërbimi për të gjithë qytetarët e Kuçovës ka vijuar të ofrohet pa ndërrprerje.

## SHQIPËRIA DHE TURQIA DISKUTOJNË RRITJEN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHË NË SHËNDETËSISË

Ministria e shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçi u takua në Ankara me Dr. Fahrettin Koca, Ministër i Shëndetësisë të Republikës së Turqisë, ku diskutuan përritjen e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Turqisë në fushën e Shëndetësisë.

Në fokus të diskutimeve ishte vazhdimi i zbatimit të autonomisë spitalore në Spitalin Memorial Fier dhe shtrirja e asistencës së bashkëpunimit, sipas këtij modeli në të gjithë sistemin spitalor publik, të lançuar edhe në QSUT "Nënë Tereza" dhe në Spitalet Rajonale të Durrësit, Vlorës, Lezhës dhe Shkodrës.



[www.shendetesia.gov.al](http://www.shendetesia.gov.al)



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



### TJETËR MODEL EKSELENT BINJAKËZIMI MES SPITALIT BASHKIAK KUÇOVË ME SPITALIN RAJONAL TË BERATIT

Pas Qendrës së parë Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", MSHMS po punon për të ngritur një tjeter model ekselektiv binjakëzimi midis Spitalit Bashkiak Kuçovë me Spitalin Rajonal të Beratit për të ofruar shërbime të specializuara pranë vendbanimit. Spitali Rajonal i Beratit ofron shërbim për 120 mijë banorë dhe rreth 700 mijë turistëve që e zgjedhin Beratin si destinacionin e pushimeve të tyre. Në këtë spital për herë të parë ka nisur këtë vit realizimi i analizave histopatologjike dhe imunohistokimike në laboratorin e anatomisë patologjike.



### FIRMOSEN MARRËVESHJET ME 15 BASHKI, MBËSHTETJE PËR QYTETARËT NË NEVOJË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mbështesë këtë vit nëpërmjet Fondit Social, 15 bashki të tjera, duke ofruar shërbime sociale në të gjithë territorin e vendit në mbështetje dhe ndihmë për fëmijët me nevoja të veçanta, familjet në nevojë, gratë e dhunuara, personat para dhe tetraplegjikë, të moshuar, grupet më në nevojë si dhe shërbim e asistencë shtëpiake për të moshuar. Me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Kryetarët e Bashkive mundësohet ngritja e 15 shërbimeve të reja sociale.



### PREJ MUAJIT SHTATOR NË SHKOLLËN "1 MAJI" FUNKSIONON KABINETI DENTAR ME KUSHTË BASHKËKOHORE

Në shkollën "1 Maji" të Beratit prej muajit shtator funksionon me kushte bashkëkohore kabineti dentar në shërbimin e tyre. Në Berat janë dy shkolla të cilat janë të pajisur me kabinete dentare ku marrin shërbim dentar mbi 1 mijë nxënës, ndërsa në të gjithë vendin janë në total 105 shkolla me kabinete dentare. MSHMS do të ndërmarrë së shpejti një tjeter angazhim për programin e depistimit të skoliozës për fëmijët në shkolla.



### DUKE DHURUAR GJAK, NË PAK MINUTA, SHPËTONI JETË

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçi, stafi i MSHMS-së kanë dhuruar gjak në godinën e re të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë dhe të gjithë personave që kanë nevojë për gjak. Ministrja Koçi apeloi që të gjithë t'i bashkohen këtij akti njerëzor dhe solidar për të shpëtar së më shumë jetë. "Ti mund të vazhdosh rutinën tënde të ditës dhe t'i kthehesh normalitetit ndërkohe ke shpëtar tre jetë njerëzish", u shpreh ministrja Koçi.